

**KËRKESË PADI**  
**Drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor ...**

- PADITËSE:** Emër Mbiemër, e bija e... dhe..., e datëlindjes..., lindur në... dhe banuese në..., madhore, me zotësi të plotë për të vepruar, përfaqësuar nga Avokat..., i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me Nr. Liçence..., me prokurë të posaçme nr...Rep, rr...Kol, datë..., para Noter...
- I PADITUR:** Emër1 Mbiemër1, i biri i... dhe..., i datëlindjes..., lindur në... dhe banues në..., madhor, me zotësi të plotë për të vepruar.
- OBJEKTI:**
1. Zgjidhja e martesës mes paditëses dhe të paditurit;
  2. Lënia e Fëmijës1 dhe Fëmijës2 paditëses për rritje dhe edukim;
  3. Detyrimi i të paditurit të kontribuojë financiarisht për rritjen dhe edukimin e fëmijëve;
  4. Caktimi i të drejtës së të paditurit për takim me fëmijët;
  5. Pjestimi i pasurisë bashkëshortore;
  6. Marrja e masës së përkohshme, duke i lënë paditëses fëmijët për rritje dhe edukim, deri sa të marrë formë të prerë vendimi për zgjidhjen e martesës, dhe duke lejuar paditësen dhe fëmijët të banojnë në banesën bashkëshortore, deri sa të marrë formë të prerë vendimi për pjestimin e pasurisë bashkëshortore.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 132, 138 dhe 139 të Kodit të Familjes.

I nderuar Z. Kryetar,

Me të paditurin Emër1 Mbiemër1 kemi lidhur martesë më ... . Martesa është lidhur pas njohjes së përbashkët dhe bashkëjetesës disa vjecare. Nga kjo martesë kanë lindur Fëmija1, i datëlindjes 2.2.1998 dhe Fëmija2, i datëlindjes 3.3.2005. Gjatë kohëvazhdimin të martesës, ne kemi kontribuar në mënyrë të përbashkët në mbajtjen e familjes dhe krijimin e pasurisë bashkëshortore.

Martesa mes nesh e ka humbur qëllimin e saj... Grindjet e vazhdueshme kanë krijuar një atmosferë të vështirë në familje dhe fëmijët po ndikohen negativisht. Megjithë përpjekjet e vazhdueshme, nuk kemi arritur t'i kalojmë këto probleme...

Për këto arsye, po ju drejtohem me këtë kërkesë për zgjidhjen e martesës mes meje dhe të paditurit, pa përcaktuar fajësinë. Përveç zgjidhjes së martesës, gjykata duhet të zgjidhë edhe pasojat e saj, si më poshtë:

1. Lënien e Fëmijës1 dhe Fëmijës2 për rritje dhe edukim. Unë i kërkoj gjykatës që fëmijët të më lihen mua për rritje dhe edukim. Unë kam të gjitha mundësitë për t'u ofruar atyre kujdesin për të cilin kanë nevojë...

2. Detyrimi i të paditurit të kontribuojë financiarisht për rritjen dhe edukimin e fëmijëve. I padituri është në marrëdhënie pune dhe ka të ardhura të mjaftueshme për të kontribuar për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tij. Në lidhje me shumën e kontributit, unë do të parqes prova për nivelin e të ardhurave të të paditurit, por përcaktimin e saj e lën në cmimin e gjykatës.

3. Caktimi i të drejtës së të paditurit për takim me fëmijët. Takimet e fëmijëve me babain e tyre janë shumë të rëndësishme për mirëqenien e tyre, prandaj përcaktimin e ditëve dhe orareve e lënë në dëshirën e të paditurit.

4. Pjestimi i pasurisë bashkëshortore. Në kohën e lidhjes së martesës, i vetmi regjim i njohur për pasurinë bashkëshortore ishte bashkësia ligjore. Kështu, cdo pasuri e vënë gjatë martesës është pjesë e pasurisë bashkëshortore. Pasuria bashkëshortore përbëhet nga: banesa bashkëshortore, e ndodhur në..., e cila është blerë në vitin 2002 dhe është i regjistruar vetëm në emër të të paditurit; apartamenti i plazhit, i ndodhur në Durrës, në adresën..., i blerë në vitin 2010, i cili është i regjistruar në emër të të dyve,; kursimet e ndodhura në dy llogari bankare të përbashkëta pranë Banka 1 dhe Banka 2, në shumën totale prej ...lekë. Në pasurinë bashkëshortore nuk duhet të përfshihen pajisjet e klinikës sime dentare (klinikë është me qira), pasi ato duhet të konsiderohen pajisje vetjake, në kuptim të nenit 77 të Kodit të Familjes. Kontributi në vënien e këtyre pasurive ka qenë i barabartë, prandaj gjatë shqyrtimit të fazës së dytë të pjestimit, do t'i kërkoj gjykatës ndarjen në raportin 50% me 50%.

5. Marrja e masave të përkohshme. Për shkak se kemi kërkuar zgjidhjen e të gjitha pasojave të martesës në një gjykim të vetëm, gjykimi mund të zgjasë, prandaj kërkojmë marrjen e masave të përkohshme, në mënyrë që zgjidhja e martesës të ndikojë sa më pak tek fëmijët. Masat që kërkohen të merren janë lënia e fëmijëve pranë paditëses për rritje dhe edukim, deri sa të marrë formë të prerë vendimi për zgjidhjen e martesës, dhe lejimi i paditëses dhe fëmijëve të banojnë në banesën bashkëshortore, deri sa të marrë formë të prerë vendimi për pjestimin e pasurisë bashkëshortore.

Bashkëlidhur kërkesë-padisë ndodhen këto prova shkresore:

- Certifikata e martesës,
- Kopje të kartave të identitetit të paditëses dhe të të paditurit;
- Certifikatat e lindjes së fëmijëve dhe kopje të kartave të tyre të identitetit;

- Vërtetime të të ardhurave të paditëses dhe të të paditurit;
- Certifikata e pronësisë mbi banesën bashkëshortore;
- Certifikata e pronësisë mbi apartamentin e plazhit;
- Të dhëna bankare...

Gjatë gjykimit do të paraqes shpjegime më të hollësishme, si edhe prova shtesë, nëse do të jenë të nevojshme.

Për sa më sipër, ju kërkoj ta merrni në shqyrtim këtë kërkesë-padi dhe të vendosni sipas objektit të saj.

Me respekt

**Emër Mbiemër**